



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti i monitorimit të II-të, përfundimtar i
Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar
për vitin 2024

Mars, 2026

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	9
MONITORIMIT DHE METODOLOGJIA.....	10
Metodologjia e monitorimit	10
Organizimi institucional i monitorimit	10
Sfidat e monitorimit.....	11
ANALIZA E PERFORMANCËS DHE NDIKIMIT RAJONAL	11
Performanca e përgjithshme e programit	11
Analiza e ndikimit sipas kategorive mbështetëse	12
Start Up Studentë dhe Start Up	12
Lot 1	14
Lot 2	16
Ndikimi i programit në zhvillim rajonal.....	17
Analiza rajonale e ndikimit.....	17
PËRFUNDIMI.....	18
ANEKS 1 Rajoni zhvillimor: Qendër.....	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 2 Rajoni zhvillimor: Veri	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 3 Rajoni zhvillimor: Perëndim.....	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 4 Rajoni zhvillimor: Jug.....	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 5 Rajoni zhvillimor: Juglindje	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 6 Rajoni zhvillimor: Lindje.....	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 7 Rajoni zhvillimor: Jugperëndim	Error! Bookmark not defined.

Lista e tabelave

Tabela 1: Zyrtarët monitorues në rajonet zhvillimore dhe numri i monitorimeve të realizuara	10
Tabela 2: Bizneset të cilat nuk janë funksionale sipas kategorisë dhe rajoneve zhvillimore	12
Tabela 3: Punësimi i gjeneruar nga projektet përfituese të kategorisë Start-Up dhe Start Up Studentë të PZHRB 2024 sipas rajoneve zhvillimore (2024–2026)	13
Tabela 4: Punësimi i gjeneruar nga projektet përfituese të kategorisë Lot 1 të PZHRB 2024 sipas rajoneve zhvillimore (2024–2026)	15
Tabela 5: Punësimi i gjeneruar nga projektet përfituese të kategorisë Lot 2 të PZHRB 2024 sipas rajoneve zhvillimore (2024–2026)	16

Lista e figurave

Figura 1: Ndryshimi neto i punësimeve 2024–2026 për bizneset përfituese të kategorisë Start Up Studentë dhe Start Up (sipas rajoneve zhvillimore).....	14
Figura 2: Ndryshimi neto i punësimeve 2024–2026 për bizneset përfituese të kategorisë Lot 1 (sipas rajoneve zhvillimore)	15
Figura 3: Ndryshimi neto i punësimeve 2024–2026 për bizneset përfituese të kategorisë Lot 2 (sipas rajoneve zhvillimore)	17

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
PZHRB	Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

HYRJE

Ky raport prezanton monitorimin e dytë dhe përfundimtar të projekteve të mbështetura në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për periudhën 2024. Monitorimi dyvjeçar është realizuar dy vite pas përfundimit të zbatimit të projekteve, me qëllim të vlerësimit të ndikimit afatmesëm, performancës dhe qëndrueshmërisë së investimeve të kryera. Ky proces synon të analizojë funksionalitetin e bizneseve përfituese, efektet ekonomike, sociale dhe rajonale, si dhe performancën e kategorive mbështetëse: Start Up-Studentë, Start Up, Lot 1 dhe Lot 2. Monitorimi përfundimtar shërben gjithashtu si bazë për përmirësimin e dizajnit të skemave të ardhshme mbështetëse dhe për rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve publike në zhvillimin rajonal.

Programi, si instrument i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, ka për qëllim uljen e pabarazive socio-ekonomike dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha rajonet e Kosovës. Në vitin 2024, janë financuar 186 biznese me një vlerë totale prej 2,509,207.92 €, duke kontribuar në krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e kapaciteteve konkurruese. Raporti përmban gjetjet kryesore të monitorimit final, të realizuar nga zyrtarët monitorues të MZHR-së në terren.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Monitorimi i dytë dhe përfundimtar i projekteve të financuara në vitin 2024 tregon se Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka krijuar ndikim të qëndrueshëm në rritjen e kapaciteteve të bizneseve dhe zhvillimin socio-ekonomik rajonal.

Numri i të punësuarve është rritur nga 427 në vitin 2024 në 664 në vitin 2026, një rritje prej 237 vendeve të punës apo shprehur në përqindje për 52.7%. Megjithëse në kategorinë Start Up evidentohet një ulje e moderuar e vendeve të punës, rritja e përgjithshme e punësimit buron kryesisht nga projektet e kategorisë Lot 2 dhe pjesërisht nga Lot 1, duke reflektuar një ndikim pozitiv të programit në nivel total.

Nga perspektiva rajonale, Jugu dhe Juglindja shfaqin performancën më të lartë, ndërsa Jugperëndimi ka një ndikim më të moderuar në punësim dhe zhvillim ekonomik.

MONITORIMIT DHE METODOLOGJIA

Metodologjia e monitorimit

Qëllimi i procesit të monitorimit është të sigurojë një vlerësim të saktë dhe të integruar të projekteve të financuara në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2024, duke analizuar ndikimin e investimeve të realizuara. Ky proces synon gjithashtu të garantojë një qasje të strukturuar dhe seriozitet institucional në raportimin e rezultateve të programit.

Monitorimi është realizuar përmes vizitave në terren nga zyrtarët monitorues, duke mbuluar të gjithë përfituesit e programit dhe verifikuar funksionimin e bizneseve përfituese si dhe përdorimin e pajisjeve të financuara përmes grantit në të gjitha kategoritë mbështetëse.

Organizimi institucional i monitorimit

Procesi i monitorimit është koordinuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), e cila ka caktuar zyrtarë monitorues në shtatë rajonet zhvillimore të Kosovës.

Zyrtarët monitorues të angazhuar në këtë proces janë:

1. Gresa Gashi, rajonin zhvillimor: Qendër;
2. Hashim Ibishi, rajonin zhvillimor: Jug;
3. Aridon Morina, rajonin zhvillimor: Veri;
4. Xhevat Sefa, rajonin zhvillimor: Perëndim;
5. Kaltrina Salihu, rajonin zhvillimor: Juglindje;
6. Ylber Salihu, rajonin zhvillimor: Lindje;
7. Kreshnik Uka, rajonin zhvillimor: Jugperëndim.

Tabela 1: Zyrtarët monitorues në rajonet zhvillimore dhe numri i monitorimeve të realizuara

Zyrtari monitorues	Rajoni zhvillimor	Start Up - Studentë	Start Up	Lot 1	Lot 2	Gjithsej
Gresa Gashi	01 - Qendër	3	11	14	8	36
Aridon Morina	02 - Veri	-	12	11	5	28
Xhevat Sefa	03 - Perëndim	-	9	7	6	22
Hashim Ibishi	04 - Jug	-	10	18	6	34
Kaltrina Salihu	05 - Juglindje	-	7	5	7	19
Ylber Salihu	06 - Lindje	1	10	10	5	26
Kreshnik Uka	07 - Jugperëndim	-	6	10	5	21
	Totali:	4	65	75	42	186

Sfidat e monitorimit

Gjatë procesit të monitorimit janë identifikuar disa sfida kryesore, kryesisht në lidhje me komunikimin me bizneset përfituese dhe aspektet logjistike të vizitave në terren:

- Vështirësi në kontaktimin e bizneseve përmes numrave kontaktues të deklaruar.
- Mungesë e informacionit të plotë ose të përditësuar nga disa përfitues.
- Sfida logjistike në realizimin e vizitave në lokacione më të largëta.
- Vështirësi në identifikimin e disa adresave të deklaruara nga bizneset përfituese.

Megjithatë, përkundër këtyre sfidave, procesi i monitorimit është zhvilluar në përputhje me standardet dhe procedurat e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, duke siguruar transparencë, rigorozitet institucional dhe një vlerësim të plotë të performancës së projekteve në të gjitha rajonet zhvillimore dhe kategoritë mbështetëse.

ANALIZA E PERFORMANCËS DHE NDIKIMIT RAJONAL

Vlerësimi i performancës së projekteve të financuara në vitin 2024 është bazuar në monitorimin e dytë dhe përfundimtar, të realizuar përmes vizitave në terren, ku u vlerësua gjendja funksionale e bizneseve përfituese.

Treguesit kryesorë të analizës përfshijnë:

- funksionalitetin e bizneseve,
- funksionalitetin e pajisjeve të përfituara dhe
- ndryshimin neto të punësimit (2024–2026).

Kjo qasje ka mundësuar një vlerësim jo vetëm të realizimit formal të projekteve, por edhe të efekteve reale ekonomike dhe sociale të programit.

Performanca e përgjithshme e programit

Nga 186 biznese përfituese të PZHRBN 2024, kanë përfituar nga mbështetja financiare, të shpërndara sipas kategorive si vijon:

- 4 përfitues – Start Up Studentë
- 65 përfitues – Start Up
- 75 përfitues – Lot 1
- 42 përfitues – Lot 2

Nga totali i përfituesve, vetëm 4 biznese rezultojnë jo funksionale në momentin e monitorimit përfundimtar, që përfaqëson një normë dështimi prej rreth 2.15%. Ky tregues konsiderohet relativisht i ulët në raport me natyrën e investimeve dhe sfidat me të cilat përballen ndërmarrjet e reja, veçanërisht gjatë fazave të para të operimit.

Ky tregues sugjeron një nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë së skemës mbështetëse, duke reflektuar një shkallë të lartë funksionaliteti dhe vazhdimësie të aktiviteteve ekonomike të bizneseve përfituese.

Bizneset që nuk janë funksionale janë të shpërndara në disa rajone zhvillimore dhe kategori të ndryshme të programit.

Tabela 2 paraqet listën e bizneseve të cilat rezultojnë jo funksionale sipas kategorisë së mbështetjes dhe rajoneve zhvillimore.

Tabela 2: Bizneset të cilat nuk janë funksionale sipas kategorisë dhe rajoneve zhvillimore

Rajoni zhvillimor	Nr. i bizneseve të mbyllura	Kategoria	Emri i bizneseve të mbyllura
01 - Qendër	1	Start Up - Studentë	Vlerë Hoxha B.I.
03 - Perëndim	1	Start Up	Anjezë Bujupi B.I.
06 - Lindje	1	Start Up	Lumturije Fetahu Berisha B.I.
	1	Lot 1	Emine Mavriqi B.I.

Shpërndarja rajonale e përfituesve tregon për një përqendrim më të madh në rajonin zhvillimor Qendër (36 përfitues), ndërsa rajoni Juglindje ka numrin më të ulët të përfituesve (19). Kjo shpërndarje reflekton diferenca në kapacitetet absorbuese, nivelin e zhvillimit ekonomik dhe potencialin ndërmarrës ndërmjet rajoneve.

Analiza e ndikimit sipas kategorive mbështetëse

Start Up Studentë dhe Start Up

Nga 4 bizneset përfituese të kategorisë Start Up - Studentë dhe 65 bizneset përfituese të kategorisë Start Up, rezulton se 3 biznese nuk janë funksionale në momentin e monitorimit: një në rajonin zhvillimor: Qendër, një në rajonin zhvillimor: Perëndim dhe një në rajonin zhvillimor: Lindje. Megjithatë, duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të përfituesve, norma e mbijetesës së bizneseve në këto kategori tejkalon 95%, çka përbën një rezultat pozitiv.

Në përgjithësi, bizneset e reja përballen me një rrezik më të lartë të dështimit gjatë viteve të para të operimit, për shkak të kufizimeve financiare, përvojës së kufizuar menaxheriale dhe sfidave të tregut. Në këtë kontekst, niveli i lartë i mbijetesës sugjeron se mbështetja e ofruar përmes programit ka kontribuar në stabilitetin dhe vazhdimësinë e aktiviteteve të ndërmarrjeve të reja.

Tabela 3 paraqet të dhënat mbi punësimin e gjeneruar nga projektet përfituese të kategorisë Start Up dhe Start Up - Studentë të PZHRB 2024, sipas rajoneve zhvillimore për periudhën 2024–2026.

Tabela 3: Punësimi i gjeneruar nga projektet përfituese të kategorisë Start-Up dhe Start Up Studentë të PZHRB 2024 sipas rajoneve zhvillimore (2024–2026)

	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfitue.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	∑ totale e projektit	Nr. të punësu. 2024	Nr. të punësu. 2026
PZHRB 2024, Start Up & Start Up - Student	01 Qendër	11	52,232.85	4,662.13	56,894.98	18	22
		3*	12,224.60	0.00	12,224.60	6	2
	02 Veri	12	57,672.50	4,533.50	62,206.00	15	14
	03 Perëndim	9	42,262.00	3,654.00	45,916.00	18	12
	04 Jug	10	46,309.00	4,124.93	50,433.93	15	14
	05 Juglindje	7	31,848.20	3,167.80	35,016.00	19	12
	06 Lindje	10	49,800.00	4,845.00	54,645.00	14	14
		1*	4,945.00	0.00	4,945.00	1	1
	07 Jugperëndim	6	27,980.00	2,490.86	30,470.86	9	7
	Totali	69	325,274.15	27,478.22	352,752.37	115	98

Nga analiza e të dhënave rezulton se projektet në këto kategori kanë kontribuar në krijimin dhe ruajtjen e vendeve të punës në rajone të ndryshme të vendit. Në vitin 2024, bizneset përfituese kanë raportuar gjithsej 115 të punësuar, ndërsa në vitin 2026 numri i të punësuarve është 98.


Pavarësisht disa rasteve të ndërprerjes së aktivitetit ose reduktimit të stafit në disa biznese individuale, shumica e ndërmarrjeve përfituese kanë arritur të ruajnë aktivitetin ekonomik dhe një pjesë të konsiderueshme të vendeve të punës.

* Start Up Studentë në rajonin zhvillimor: Qendër

* Start Up Studentë në rajonin zhvillimor: Lindje

Figura 1 paraqet ndryshimin neto të punësimeve për bizneset përfituese të kategorisë Start Up dhe Start Up Studentë sipas rajoneve zhvillimore për periudhën 2024–2026.

Figura 1: Ndryshimi neto i punësimeve 2024–2026 për bizneset përfituese të kategorisë Start Up Studentë dhe Start Up (sipas rajoneve zhvillimore)



Lot 1

Në kategorinë Lot 1, 75 biznese gjithsej kanë përfituar mbështetje financiare nga programi. Nga këto, vetëm 1 biznes rezulton jo funksional në momentin e monitorimit përfundimtar (në rajonin zhvillimor Lindje), çka tregon një nivel të lartë funksionaliteti dhe qëndrueshmëri të investimeve të realizuara përmes kësaj skeme mbështetëse.

Sa i përket ndikimit në punësim, të dhënat tregojnë një rritje të përgjithshme të numrit të vendeve të punës gjatë periudhës 2024–2026. Numri i të punësuarve në bizneset përfituese është rritur nga 172 në vitin 2024 në 229 në vitin 2026, që përfaqëson një rritje neto prej 57 vendeve të reja të punës. Kjo rritje reflekton zgjerimin gradual të aktiviteteve ekonomike të bizneseve përfituese dhe konsolidimin e kapaciteteve të tyre gjatë periudhës pas përfundimit të investimeve. Në veçanti, disa nga projektet kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese, duke krijuar nevojë për shtim të stafit dhe përforsim të strukturës së punësimit në ndërmarrje.

Tabela 4 paraqet të dhënat e detajuara mbi investimet dhe punësimin në kuadër të projekteve Lot 1 sipas rajoneve zhvillimore.

Tabela 4: Punësimi i gjeneruar nga projektet përfituese të kategorisë Lot 1 të PZHRB 2024 sipas rajoneve zhvillimore (2024–2026)


	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfitue.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Σ totale e projektit	Nr. të punës. 2024	Nr. të punës. 2026
PZHRB 2024, Lot 1	01 Qendër	14	196,747.40	31,873.36	228,620.76	38	28
	02 Veri	11	150,569.42	36,799.67	187,369.09	29	36
	03 Perëndim	7	96,400.00	25,115.00	121,515.00	13	23
	04 Jug	18	233,676.40	62,058.40	295,734.80	36	65
	05 Juglindje	5	70,350.00	20,167.00	90,517.00	10	22
	06 Lindje	10	130,492.50	31,027.50	161,520.00	19	31
	07 Jugperëndim	10	143,868.40	29,915.60	173,784.00	27	24
	<i>Totali</i>	75	1,022,104.12	236,956.53	1,259,060.65	172	229

Analiza sipas rajoneve zhvillimore tregon se rritja më e theksuar në rajonin Jug lidhet me përqendrimin më të madh të projekteve prodhuese dhe shërbyese të cilat kanë kërkuar zgjerim të kapaciteteve njerëzore gjatë fazës së konsolidimit të biznesit. Ndërkohë, disa rajone kanë shënuar një ulje të moderuar të numrit të të punësuarve.

Pavarësisht këtyre luhatjeve rajonale, trendi i përgjithshëm i punësimit në kuadër të projekteve Lot 1 mbetet pozitiv, duke treguar se mbështetja e ofruar përmes programit ka kontribuar në zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Figura 2 paraqet ndryshimin neto të punësimeve për bizneset përfituese të Lot 1, sipas rajoneve zhvillimore për periudhën 2024–2026.

Figura 2: Ndryshimi neto i punësimeve 2024–2026 për bizneset përfituese të kategorisë Lot 1 (sipas rajoneve zhvillimore)



Lot 2

Në kuadër të kategorisë Lot 2, gjithsej 42 biznese kanë përfituar mbështetje financiare nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) i vitit 2024. Vlera totale e investimeve të realizuara arrin mbi 1,6 milion euro, nga të cilat mbi 1,1 milion euro përbëjnë kontributin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe mbi 400 mijë euro kontributin e përfituesve.

Tabela 5 paraqet të dhënat mbi punësimin e gjeneruar nga projektet përfituese të kategorisë Lot 2 sipas rajoneve zhvillimore për periudhën 2024–2026.

Tabela 5: Punësimi i gjeneruar nga projektet përfituese të kategorisë Lot 2 të PZHRB 2024 sipas rajoneve zhvillimore (2024–2026)

	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfitue.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Σ totale e projektit	Nr. të punës. 2024	Nr. të punës. 2026
PZHRB 2024, Lot 2	01 Qendër	8	227,700.00	101,027.42	328,727.42	19	44
	02 Veri	5	34,880.00	39,420.00	174,300.00	25	55
	03 Perëndim	6	173,800.00	79,430.00	253,230.00	18	72
	04 Jug	6	155,098.40	58,629.10	213,727.50	25	42
	05 Juglindje	7	184,638.75	74,044.25	258,683.00	25	84
	06 Lindje	5	139,500.00	44,000.00	183,500.00	14	21
	07 Jugperëndim	5	146,212.50	60,037.50	206,250.00	14	19
	<i>Totali</i>	42	1,161,829.65	456,588.27	1,618,417.92	140	337


Sa i përket ndikimit në punësim, projektet e financuara në kuadër të kategorisë Lot 2 kanë shënuar një rritje të konsiderueshme të numrit të të punësuarve gjatë periudhës së monitorimit. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në bizneset përfituese është rritur nga 140 në vitin 2024 në 337 në vitin 2026, që përfaqëson një rritje neto prej 197 vendeve të reja të punës.

Analiza sipas rajoneve zhvillimore tregon se rritja e punësimit është shpërndarë në të gjitha rajonet, megjithëse me intensitet të ndryshëm. Rritja më e theksuar evidentohet në rajonin Juglindje (+59 vende pune) dhe rajonin Perëndim (+54 vende pune), të ndjekura nga rajoni Veri (+30) dhe rajoni Qendër (+25). Ndërkohë, rajonet Jug, Lindje dhe Jugperëndim kanë shënuar rritje më të moderuar të punësimit.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se ndërhyrjet në kuadër të kategorisë Lot 2 kanë pasur një ndikim të dukshëm në zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve përfituese dhe në krijimin e vendeve të reja të punës në nivel rajonal.

Figura 3 paraqet ndryshimin neto të punësimeve për bizneset përfituese të kategorisë Lot 2 sipas rajoneve zhvillimore gjatë periudhës 2024–2026.

Figura 3: Ndryshimi neto i punësimeve 2024–2026 për bizneset përfituese të kategorisë Lot 2 (sipas rajoneve zhvillimore)



Projektet e kategorisë Lot 2 rezultojnë të kenë ndikimin më të madh në krijimin e vendeve të punës, duke kontribuar me mbi 70% të rritjes neto të punësimit gjatë periudhës së monitorimit.

Ndikimi i programit në zhvillim rajonal

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2024 ka pasur një ndikim të dukshëm në krijimin dhe ruajtjen e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e mbështetjes: Start Up - Student dhe Start Up, Lot 1 dhe Lot 2. Analiza e të dhënave tregon se ndërhyrjet e realizuara kanë kontribuar jo vetëm në qëndrueshmërinë e bizneseve përfituese, por edhe në zhvillimin ekonomik rajonal.

Analiza rajonale e ndikimit

Analiza sipas rajoneve zhvillimore tregon se programi ka pasur një shpërndarje të ndryshme të ndikimit, duke reflektuar kapacitetet lokale dhe potencialin ndërmarrës:

- Rajoni zhvillimor Juglindje ka përfituar më shumë nga Lot 2, me rritje të punësimit nga 25 në 84 të punësuar.
- Rajoni zhvillimor Perëndim ka pasur gjithashtu rritje të dukshme, nga 18 në 72 të punësuar.
- Rajoni zhvillimor Qendër ka shënuar rritje të moderuar, nga 19 në 44 të punësuar.

- Rajonet zhvillimore Lindje dhe Jugperëndim kanë pasur rritje më të vogël, duke reflektuar potencial më të kufizuar për ndërmarrësi dhe absorbim të investimeve.
- Rajoni zhvillimor Jug ka kontribuar kryesisht për Lot 1, me rritje nga 36 në 65 të punësuar.

Kjo analizë tregon se programit ka krijuar një efekt të dukshëm rajonal, duke kontribuar në rritjen e punësimit në të gjitha rajonet, por me intensitet më të lartë në ato me potencial më të madh ndërmarrës dhe më shumë biznese përfituese.

PËRFUNDIMI

Monitorimi i dytë dhe përfundimtar i projekteve të financuara në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2024 ofron një vlerësim të plotë mbi rezultatet dhe ndikimin e investimeve të realizuara në zhvillimin ekonomik dhe rajonal të vendit. Përmes këtij programi janë mbështetur gjithsej 186 biznese në shtatë rajonet zhvillimore të Kosovës, me një vlerë totale investimesh prej 2,509,207.92 €, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve përfituese dhe në zgjerimin e aktiviteteve ekonomike në nivel lokal dhe rajonal.

Gjetjet e monitorimit tregojnë një nivel të lartë të funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së bizneseve të mbështetura. Nga totali i përfituesve, vetëm një numër shumë i vogël rezultojnë jo funksional në momentin e monitorimit, duke reflektuar një normë funksionaliteti prej rreth 97.9%. Ky rezultat dëshmon se shumica e ndërmarrjeve kanë arritur të vazhdojnë aktivitetin ekonomik edhe dy vite pas përfundimit të zbatimit të projekteve, duke treguar se investimet e realizuara përmes programit kanë krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Programi ka gjeneruar gjithashtu ndikim të dukshëm në krijimin dhe zgjerimin e vendeve të punës. Numri i të punësuarve në bizneset përfituese është rritur nga 427 në vitin 2024 në 664 në vitin 2026, duke shënuar një rritje prej rreth 52.7%. Kjo rritje reflekton zgjerimin gradual të aktiviteteve ekonomike të bizneseve dhe konsolidimin e tyre gjatë periudhës së monitorimit.

Analiza sipas kategorive mbështetëse tregon se instrumentet e ndryshme të programit kanë prodhuar efekte të ndryshme në zhvillimin e ndërmarrjeve përfituese. Projektet e kategorisë Start Up dhe Start Up – Studentë kanë kontribuar kryesisht në nxitjen e ndërmarrësisë dhe krijimin e bizneseve të reja, ndërsa projektet e kategorive Lot 1 dhe veçanërisht Lot 2 kanë

gjeneruar ndikim më të madh në zgjerimin e kapaciteteve ekonomike dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Në veçanti, projektet e financuara përmes Lot 2 rezultojnë të kenë dhënë kontributin më të madh në rritjen neto të punësimit gjatë periudhës së monitorimit.

Nga perspektiva rajonale, programi ka prodhuar efekte pozitive në të gjitha rajonet zhvillimore të vendit. Edhe pse intensiteti i ndikimit ndryshon ndërmjet rajoneve, ndërhyrjet e realizuara kanë kontribuar në rritjen e punësimit, zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe në forcimin e bazës ndërmarrëse në nivel lokal. Në tërësi, rezultatet e monitorimit konfirmojnë se Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka qenë një instrument efektiv i mbështetjes së zhvillimit ekonomik dhe të balancuar rajonal, duke demonstruar një përdorim efikas të fondeve publike dhe një ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.